



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 140 - Korrik 2015 - ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>



PAMJE GJATË FUSHATËS SË KORRJE SHIRJEVE NË KOMUNËN E MALISHEVËS

Përmbajtja:

Komiteti për Politikë dhe Financa mbajti mbledhjen e shtatë të rregullt	3
Kryetari Begaj takoi përfaqësuesit e LMT-së në Malishevë	3
U mbajt Punëtorja rreth komunikimit të brendshëm në Malishevë	4
50.54 për qind e maturantëve e kanë kaluar testin e maturës	5
Drejtorja e Bujqësisë ndau edhe tri serra për bujqit vendas	5
Komuna dhe ESC International GMBH, bashkëpunojnë në ndërtimin e ndriçimit solar	6
Ka filluar fushata e korrje shirjeve në Malishevë.....	7
Filloi fushata e korrjes së grurit në Malishevë	8
Asgjësohen 96 krerë dhi të sëmura nga brucezoza.....	8
Kryetari Begaj priti përfaqësuesit e Qendrës Rinore të Malishevës.....	9
Kuvendi i Komunës mbajti mbledhjen e shtatë për këtë vit.....	10
Gjatë javës së shkuar ka pasur disa zjarre fushore	10
U promovua libri “Prijës fetar dhe shpirtërorë të shqiptarëve” i autorit Faton Mehmetaj	11
KE i EVSB-ve në Kosovë, mbajti mbledhjen e rregullt.....	12
Begaj, shtroi iftar për familjet e dëshmorëve	13
Ndihmohen 180 familje në prag të festës së Bajramit	14
Kryetari Begaj, uron të gjithë besimtarët islam me rastin e Fitër Bajramit	14
Krasniqi: Raporti i auditorit tendencioz dhe jo real. Presim marrjen e masave nga organi përkatës	15
Po mbahet Kampi Rinor dy ditor në liqenin e Mirushës.....	16
Mungesa e reshjeve po përcillet me reduktime në furnizim me ujë për pije.....	16
K.N. “Besa”, fituese e garës së notit - “Esmir Shala”	17
Përfundon fushata e korrje-shirjeve në Malishevë.....	18
Kryetari Begaj priti kampionin e botës në kik boks Dardan Morina	19
U mbajt debati “Të rinjtë kundër duhanit” në Malishevë	19
Malishevë, 65 raste zjarri vetëm në muajin korrik	20
Kryetari Begaj priti palët	21

Komiteti për Politikë dhe Financa mbajti mbledhjen e shtatë të rregullt

Malishevë, 1 korrik

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), i drejtuar nga kryesuesi i KK të Malishevës, z. Aziz Thaçi, sot ka mbajtur mbledhjen e saj të shtatë të rregullt, ku edhe i kanë dhënë katër rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, në mesin e tyre, rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

Përveç kësaj rregullore, KPF, ka shqyrtuar dhe i ka rekomanduar për mbledhjen e radhës së Kuvendit të Komunës, kanë rekomanduar edhe tri pika tjera, si dhe ka shqyrtuar edhe kërkesat e drejtuara për KPF.

Kryetari Begaj takoi përfaqësuesit e LMT-së në Malishevë

Malishevë, 2 korrik



Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Ragip Begaj, ka pritur sot në një takim udhëheqësin e njësisë LMT të KFOR-it në Malishevë, kapitenin Flavio Lötcher, me të cilin kanë biseduar për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me Komunën e Malishevës dhe bashkëpunimin e ndërsjellë.

Kryetari Begaj, e njoftoi kapitenin Lötcher, lidhur me zhvillimet e përgjithshme në Komunën e Malishevës, angazhimet e komunës në rritjen e mirëqenies së qytetarëve, përmes investimeve në projektet konkrete që ndikojnë në jetesën e banorëve në vendbanimet e tyre, si dhe me aktivitetet e fundit, përkatësisht për debatin publik të kryetarit.

“Unë në punën time dhe të qeverisë të cilën e drejtoj, asnjëherë investimet nuk i drejtoj në aspektin politik, të gjitha investimet i bëjmë pa dallime politike dhe aty ku konsiderojmë që ka nevojë më shumë dhe sipas mundësive buxhetore që kemi si komunë”, tha kryetari Begaj.

Nga ana tjetër, kapiteni Lötcher, e vlerësoi punën e komunës në raport me angazhimet për realizimin e projekteve të ndryshme, si dhe vlerësoi lartë bashkëpunimin e ndërsjellë me komunën.

U mbajt Punëtorja rreth komunikimit të brendshëm në Malishevë

Malishevë, 2 korrik

Në kuadër të projektit të OSBE-së, “Përkrahje të qeverisjes lokale në Kosovë” i dhe inicim të komunës në përpilim të strategjisë së komunikimit, u mbajt punëtorja rreth komunikimit të brendshme. Qëllimi i punëtorisë ishte vlerësimi i mekanizmave dhe praktikave ekzistuese të komunikimit, të identifikoj sfidat dhe të ofroj zgjidhje të mundshme për komunikim dhe koordinim në mes të akterëve/bashkëpunorëve të brendshëm.



Fillimisht Kryetari i Komunës z.Ragip Begaj, pasi përshëndeti pjesëmarrësit e këtij takimi tha se” Ky projekt vetëm zbatohet

nga ana jonë dhe kjo punë çmohet dhe vlerësohet lartë, ne po mundohemi të fuqizojmë këtë dhe ky projekt e ndihmon ecjen përpara të kësaj praktike, ku ne synojmë që edhe kryetarët e fshatrave të fuqizojmë, komunikimi më efikas është ai i drejtpërdrejt, dhe qytetarët duhet të jenë të informuar për të gjitha ngjarjet, të gjitha takimet dhe mbledhjet janë të hapura dhe transparente, unë kërkoj që edhe shoqëria civile duhet të jenë më aktive në mënyrë që të ndikon në rritjen komunikimit dhe transparencës”.

Ndërsa prezantimin e projektit e bëri përfaqësuesi nga OSBE z.Yusuke Hara, ku prezantoi disa nga objektivat e projektit, si rritja e kuptimit të mekanizmave ekzistues dhe praktikave të komunikimit të brendshëm. Identifikimi i sfidave dhe diskutimi rreth zgjidhjeve të mundshme për komunikim dhe koordinim më të mirë përbrenda bashkëpunorëve/zyrtarëve komunal etj...

Po ashtu gjatë kësaj punëtorie ka pasur edhe diskutim rreth shkëmbimit të informatave për brenda drejtorive komunale, diskutimi rreth sfidave lidhur me dokumentet publike dhe kërkesave administrative, diskutimi rreth komunikimit në mes të autoritetit ekzekutiv dhe legjislativ

Prezantimi rreth ndryshimeve/plotësimeve në rregulloren komunale për transparencë etj...ku dhe gjatë këtyre diskutimeve janë nxjerrë edhe rekomandime me qëllim të përpilimit të strategjisë së komunikimit.

50.54 për qind e maturanëve e kanë kaluar testin e maturës

Malishevë, 3 korrik

Bazuar në raportin e drejtorisë komunale për arsim, në fazën e parë të testit të maturës, këtë test e kanë kaluar 50.54 për qind e maturanëve që i janë nënshtruar testit, ndërsa shkalla e kalueshmërisë në testin e arritshmërisë për klasat e nënta, është 60.19 për qind.

Këto shifra i ka deklaruar sot, drejtori komunal për arsim dhe edukim, z.Blerim Thaçi, duke u bazuar në rezultatet e grumbulluara të testeve të mbajtura për nxënësit e klasave të nënta dhe atij të maturës. “Duke u bazuar në të dhënat që kemi grumbulluar, testit të maturës i janë nënshtruar 1108 maturanë, ku 560 prej tyre e kanë kaluar testin, ndërsa testit të arritshmërisë i janë nënshtruar 1542 nxënës, ndërsa kalueshmëria është 60.19 për qind, apo 925 nxënës”, tha drejtori Thaçi.

Faza e dytë e testit të maturës, duhet të mbahet në muajin gusht.

Drejtorja e Bujqësisë ndau edhe tri serra për bujqit vendas

Malishevë, 3 korrik



Komuna e Malishevës, përkatësisht Drejtori për Bujqësi, sot ka përfunduar shpërndarjen e tri serra, për kultivimin e perimeve. Të tri rastet e dhënies së këtyre serrave, janë raste të rënda sociale, njëri prej tyre veteran i UÇK-së, dhe kjo ka qenë arsyeja e dhënies së serrave për këto tri familje malishevase, ka bërë të ditur, drejtori për bujqësi, z.Hajrullah Mazreku.

Përfitues të këtyre tri serrave, janë kryefamiljarët, Bukurije Kastrati nga Turjaka, Faik Zogaj nga Mleqani dhe Osman Gashi nga Ploqica e ulët. “I kemi përzgjedhur këto tri familje, të cilët jetojnë në kushte jo të mira ekonomike, dhe qëllimi ynë ka qenë që, në kuadër të përkrahjes për fermerët vendas, edhe këto familje të kenë mundësi të punojnë dhe të sigurojnë të hyra”, tha drejtori Mazreku.

“Qëllimi i qeverisjes Begaj, është rritja e mirëqenies sociale, përmes investimeve direkte në krijimin e kushteve për punë, për të gjithë dhe brenda mundësive buxhetore të komunës, jemi duke u munduar të bëjmë investime në fushën e bujqësisë, në mënyrë që përveç sigurimit të

të hyrave për këto familje, edhe tregu vendas të furnizohet me prodhime vendore”, tha drejtori Mazreku.

Përndryshe, rasti i veteranit të UÇK-së, Faik Zogaj, është njëri prej rasteve më të veçanta, pasi ky i fundit, publikisht, kishte vendosur të shesë çdo që kishte dhe të merrte rrugën ilegale të mërgimit, por ka qenë këmbëngulja e kryetarit Begaj, që veterani Zogaj, të mos largohet nga vendi, jo në këtë formë, ndërsa komuna, do të interesohet që ta ndihmoj. Me këtë rast, Kryetari i Komunës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur premtimin e bërë dhe është ndihmuar me një serrë për kultivimin e perimeve nga edhe mund të punoj dhe të siguroj të ardhura për familjen e tij.

Me këtë rast, fermeri Zogaj, e falënderon kryetarin Begaj dhe drejtorin e bujqësisë Mazrekun, për këtë ndihmë të dhënë, dhe që nuk e kanë lejuar të marr rrugën ilegale të mërgimit, drejt vendeve të BE-së.

Vlera e këtij projekti për ndërtimin e tri serrave, kap një shumë prej 3 382 euro.

Komuna dhe ESC International GMBH, bashkëpunojnë në ndërtimin e ndriçimit solar

Malishevë, 3 korrik

Komuna e Malishevës dhe Energie save consulting International GMBH, sot kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, me qëllim të për të bashkëpunuar në sferën e ndriçimit publik me ndriçim solar. Ky ndriçim, pritet të realizohet në fazën e parë të projektit 2015-2016, ku kompania, do të bëjë projektin e ndriçimit solar.



Memorandumin e mirëkuptimit, e kanë nënshkruar kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe Shkelzim Murtezi nga ESC International GMBH.

Një prej objektivave të kësaj marrëveshje, është edhe arritja e nevojës së komunës, për zvogëlimin e shpenzimeve në ndriçimin publik, nga shfrytëzimi i energjisë elektrike, me energji diellore.

Ka filluar fushata e korrje shirjeve në Malishevë

Malishevë, 6 korrik



Edhe pse rekomandimi i drejtorisë komunale për bujqësi, ka qenë që fushata e korrje shirjeve të mos filloj para datës 10 korrik, megjithatë kjo fushatë nga ana e pronarëve grurit dhe autokombajnerëve. Kështu është njoftuar sot, në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, të cilën e udhëheq kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, e ku drejtorët komunal raportojnë për punët dhe aktivitetet javore.

“Ne kemi rekomanduar që fushata e korrje shirjeve të mos filloj para datës 10 korrik, mirëpo korrja e grurit ka filluar nga ana e pronarëve të tokave. Megjithatë, komisioni komunal, i caktuar për mbikëqyrjen e fushatës së korrje shirjeve, do të dalë në terren dhe do të bëj vlerësimin e shkallës së lagështisë së grurit, prej ku edhe do të dalim me vlerësimin tonë”, tha drejtori i bujqësisë, z.Hajrullah Mazreku. Mazreku, po ashtu bëri të ditur, se është duke vazhduar faza e tretë e repelimit të kafshëve, si masë parandaluese nga thumbimi i rriqrave dh kjo fushatë ka shkuar shumë mirë.

Edhe drejtori i shëndetësisë, z.Hajdin Berisha, duke folur për situatën endemike me EHKK, tha se “rastet thumbimeve nga rriqrat janë në suaza të normales dhe fatmirësisht, deri më sot nuk kemi asnjë rast të infektimit me ethe hemorragjike krime kongo (EHKK)”.

Ndërsa, sipas drejtorëve tjerë, janë duke u realizuar disa punime, përkatësisht projekte infrastrukturore, ku ka përfunduar rregullimi i çerdhes për fëmijë dhe pritjet vetëm plotësimi me inventarin nevojshëm, pastaj, në ndërtim e sipër disa objekte shkollore, rrugë dhe projekte tjera.

Sa i përket arsimit, i tha se përveç përfundimit të testit të maturës dhe testit të arritshmërisë, në shkollat e mesme të Malishevës, është bërë regjistrimi i nxënësve në klasat dhjeta, ku në gjimnaz është plotësuar numri dhe ka të paraqitur rreth 200 nxënës më shumë, ndërsa ka vende të lira në shkollën profesionale në Kijevë dhe në Qendrën e Kompetencës në Malishevë.

Filloi fushata e korrjes së grurit në Malishevë

Malishevë, 6 korrik



Ka filluar fushata e korrje shirjeve, apo grumbullimi i grurit në Komunën e Malishevës. Fillimin e korrjes së grurit, sot e ka përcjellë nga afër edhe i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj, kryesuesi i KK të Malishevës, z.Aziz Thaçi, drejtori për bujqësi, z.Hajrullah Mazreku dhe komisioni komunal për monitorimin e korrje shirjeve në Malishevë. Me këtë rast, i kanë uruar pronarët, për grumbullimin e grurit.

“Uroj që rendimenti të jetë sa më i madh. Korrja e grurit, është festë, pasi sot ju po e bëni grumbullimin e grurit, përkatësisht po e siguron bukën, e cila realisht fitohet me punë dhe mund të madh, por futja në hambar e grurit është festë dhe uroj që të gjeni sa më shumë grurë”, tha kryetari Begaj, gjatë vizitës në arat me grurë, në të cilat ka filluar korrja e grurit.

Për korrjen dhe grumbullimin e grurit, i ka uruar edhe kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës, z.Aziz Thaçi, si dhe drejtori për bujqësi, z.Hajrullah Mazreku.

Drejtori për Bujqësi, z.Mazreku, tha se “ drejtorja ka planifikuar fillimin e korrjes së grurit rreth datës 10 korrik, mirëpo pronarët e tokave me grurë e kanë filluar korrjen e grurit. Megjithatë, bazuar në matjet për lagështinë e grurit, rezulton të jetë në rregull dhe pa rrezik edhe pse është filluar para kohe. Lagështia e grurit është brenda parametrave të lejuar për korrjen e grurit”.

Në territorin e Komunës së Malishevës, janë të mbjella 3722 hektar me grurë, ndërsa pritet që në fushatën e korrje shirjeve të angazhohen mbi 30 kombajna nga komuna jonë, si dhe kombajna tjera të ardhura nga lokalitet jashtë Malishevës, ndërsa fushata e korrje shirjeve, pritet të përfundoj brenda 20 ditëve, varësisht edhe prej kushteve atmosferike.


Asgjësohen 96 krerë dhi të sëmura nga bruceloza

Malishevë, 9 korrik

Me vendim të Agjencisë së Veterinës dhe Ushqimit të Kosovës, me asistimin e inspektorëve komunal, sot në fshatin Gajrak, janë asgjësuar 96 krerë dhi dhe një gjedh, të prekura nga sëmundja e “brucelozës”. Asgjësimi është bërë, në kuadër të mbrojtjes së shëndetit dhe eliminimit të kësaj sëmundje, në mënyrë që të mos përhapet më shumë.


Sipas pronarëve, nga kjo sëmundje janë prekur edhe disa anëtar të familjes së tij, të cilët janë duke u trajtuar.

Asgjësimi i këtyre kafshëve shtëpiake, është bërë në mënyrë profesionale, sipas rregullave për asgjësimin e kafshëve të sëmura dhe janë varrosur në varrezat e kafshëve, vendi i cili është i kufizuar për varreza të kafshëve të cilat asgjësohen në raste kur kanë sëmundje.



Kryetari Begaj priti përfaqësuesit e Qendrës Rinore të Malishevës

Malishevë, 9 korrik



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, znj.Blerta Krasniqi, sot kanë pritur në një takim përfaqësuesit e Qendrës Rinore të Malishevës, përkatësisht kryetarin e kësaj qendre, z.Amrush Helshani, të cilët prezantuan para kryetarit Begaj, aktivitetet e të rinjve dhe falënderuan kryetarin për përkrahjen e deritanishme.

Kryetari Begaj, i uroi për veprimtaritë e tyre rinore. ” Ne po mundohemi që të ndihmojmë të rinjtë tanë, dhe dëshira ime është që ju të ecni përpara, ngase e ardhmja e vendit është në duart tuaja , presim nga ju shumë, presim që ju si të rinj të largoni çdo dukurit negative, dhe të ndihmoni vendin tuaj, unë do mundohem të ju përkrah përkundër asaj që nuk qëndrojmë mirë ekonomikisht si Malishevë”, tha Begaj.

Nga ana tjetër kryetari i Qendrës Rinore në Malishevë, z.Amrush Helshani e njoftoi kryetarin Begaj për aktivitetet që nga zgjedhja e tyre.” Kemi zhvilluar aktivitetet të ndryshme ne si Qendër Rinore, si trajnime, debate e aktivitete tjera rinore të përkrahura nga komuna vazhdimisht, po ashtu një gjë çka vlen të njoftoheni është se një numër i madh i të rinjve po interesohen për anëtarësim në Qendren Rinore” tha Helshani para kryetarit Begaj.

Kuvendi i Komunës mbajti mbledhjen e shtatë për këtë vit

Malishevë, 10 korrik



Kuvendi i Komunës (KK) së Malishevës, sot ka mbajtur mbledhjen e shtatë të rregullt, ku ka shqyrtuar dhe miratuar dy kërkesa të qytetarëve, si dhe ka miratuar ndryshimet e kërkuara nga MAPL, për rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale. Mbledhja është udhëhequr nga kryesuesi i KK-së, z.Aziz Thaçi, ndërsa në mbledhje ka marrë pjesë edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe disa drejtor komunal,

e të cilët janë përgjigjur edhe në pyetjet e anëtarëve të KK-së, për çështje të ndryshme.

Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e sotme, miratoi kërkesat e dy qytetarëve, të cilët kishin kërkuar të bënin ndërrim destinimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Po ashtu miratuar edhe disa ndryshime në Rregulloren Komunale për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale, për vitin 2015.

Mbledhja e ardhshme e Kuvendit të Komunës, pritet të mbahet në fund të muajit gusht.

Gjatë javës së shkuar ka pasur disa zjarre fushore

Malishevë, 13 korrik

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, sot ka mbajtur mbledhjen e rregullt e Këshillit të Drejtorëve, ku është raportuar për punët dhe aktivitetet e drejtorive, gjatë javës së shkuar dhe për aktivitetet e tyre në javët në vijim. Sipas drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, gjatë javës së shkuar janë regjistruar disa zjarre, kryesisht fushore dhe zjarre tjera, por jo me dëme të mëdha, ndërsa një rast ka qenë më i rëndë, kur janë dëmtuar rreth 70 ari me grurë.

Në këtë mbledhje, drejtorja për kulturë, bëri të ditur se janë në përgatitje të festivalit “Oda e Llapushës”, që zhvillohet në kuadër të ditës së mërgatës. E kur jemi të mërgimtarët, edhe drejtorja e administratës, ka bërë të ditur se, janë të përgatitur për ofrimin e shërbimeve më të shpejta në këtë sezon, kur edhe qëndrojnë mërgimtarët për pushime.

Përndryshe, sipas drejtorive tjera komunale, janë duke vazhduar punimet në disa projekte kapitale, si rrugë, shkolla dhe infrastrukturë tjetër. Në mbledhjen e sotme, nga drejtorja për gjeodezi dhe kadastrë, u bë e ditur se marrë parasysh rekomandimet e komunës, për Fshatin e Ri, dhe ky fshat do ta ketë zonën e vet kadastrale.

Drejtoria e inspektoratit, ka bërë të ditur se në bashkëpunim me AVUK, janë asgjësuar 96 dhi, të cilat kanë rezultuar me “brucelozë”. Edhe drejtoria e shëndetësisë ka bërë të ditur, se për rastin e “brucelozës”, janë të njoftuar organet përgjegjëse dhe mbahen në vëzhgim dhe kujdes të vazhdueshëm, ndërsa për situatën me ethe hemorragjike, u tha se çdo është në kontroll dhe nuk ka raste të infektimit me EHKK.

Për mbrojtje nga ethet hemorragjike, si masë mbrojtëse, është edhe repelimi i kafshëve shtëpiake, ku sipas drejtorisë për bujqësi, ka përfunduar me sukses edhe faza e tretë e repelimit të kafshëve. Po ashtu drejtoria për bujqësi, bëri të ditur se edhe fushata e korrje shirjeve po ecën mbarë dhe po shkon përfundimit.

U promovua libri “Prijës fetar dhe shpirtërorë të shqiptarëve” i autorit Faton Mehmetaj

Malishevë, 13 korrik



Në kuadër të promovimit të veprës së tij, “Prijës fetar dhe shpirtërorë të shqiptarëve –Bashkëjetesa ndërfitetare dhe kontributi i tyre kombëtar”, autori Faton Mehmetaj, sot në Malishevë, e ka bërë promovimin e këtij libri, i cili u cilësua si një libër monumental i tolerancës ndërfitetare të popullit shqiptar.

Fillimisht, kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, duke

folur rreth kësaj vepre dhe tolerancës ndërfitetare, tha se “populli shqiptar, gjithmonë ka qenë popull i sakrificave, por religjionet tek ne, asnjëherë nuk kanë krijuar urrejtje, por përkundrazi, pasi besimi nuk e lejon urrejtjen”. “Çdo vepër e shkruar është e mirëseardhur, në veçanti veprat e këtilla, që kanë për qëllim ti bashkojnë njerëzit”, tha mes tjerash në fjalën e tij, kryetari Begaj.

“Mbledhja e 600 biografive të prijësve shpirtëror shqiptar është punë e madhe, por në autori në mënyrën më të mirë e ka përshkruar tolerancën ndërfitetare”, tha recensenti i librit, Ahmet Qeriqi. Ndërsa për recensentin Fahredin Shehu “ky libër është monumental për edukimin shpirtëror dhe i tolerancës ndërfitetare”.

“Kjo që kam bërë, është një pikë uji në oqean, pasi duhen qindra vite për ti studiuar të gjithë ata prijës shqiptar, që kanë kontribuar në çështjen kombëtare dhe në ruajtjen e tolerancës ndërfitetare të popullit shqiptar, gjë na bën të jemi unik në bashkëjetesën fetare”, tha autori, i

cili i falënderoi të gjithë ata që e kanë përkrahur në hulumtimin, pastaj botimin dhe tani promovimin e librit.

KE i EVSB-ve në Kosovë, mbajti mbledhjen e rregullt

Malishevë, 14 korrik



Këshilli Ekzekutiv (KE) i Ekipeve Vepruese për Siguri në Bashkësi (EVSB), sot në Malishevë, ka mbajtur mbledhjen e rregullt të saj, ku është paraqitur puna dhe aktiviteti i EVSB-ve në të gjitha qendrat e vendit (ku janë të formuara), si dhe u bë një prezantim i përgjithshëm për punën dhe rolin EVSB-ve, gjatë këtyre gjashtë muajve.

Fillimisht, punimet e KE të EVSB-ve, i përshëndeti i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj, i cili në emër të komunës, ju dëshiroj punë të mbarë dhe suksese në këtë aktivitet, vullnetar, që ka për qëllim krijimin e një ambienti të sigurt për qytetarët. “Sa i përket Malishevës, situata e sigurisë është e qetë dhe në nivel të mirë”, tha kryetari Begaj, përderisa lavdëroi edhe punën e EVSB-së në Malishevë në këtë drejtim.

Punimet e KE të EVSB-ve, i përshëndeti edhe znj.Drita Perizic nga ICITAP.

Më pas, z.Imer Thaçi nga Ministria e Punëve të Brendshme, foli për EVSB-të dhe rëndësinë e këtyre ekipeve, si dhe për aktivitetet në nivel vendi, në 34 komunitat, ku janë të formuara EVSB-së. më pas, z.Thaçi, foli edhe sfidat e EVSB-ve, e që sipas tij, sfidë në punën e tyre janë, komunikimi, ngritja e vetëdijes dhe qëndrueshmëria.

Për situatën e sigurisë në Malishevë, një gjendje të përgjithshme të kësaj situate e prezantoi, komandanti i stacionit policor në Malishevë, kapiteni Halil Morina, ku sipas tij, gjendja e sigurisë, është e qetë dhe stabile, me tendencë të rënies të rasteve që kanë të bëjnë me krimet. Gjatë prezantimit të tij, kapiteni Morina, tha se “në Malishevë, ka rënie të dukshme të rasteve të krimit”.

Ndërsa për rolin e EVSB-ve dhe bashkëpunimin mes EVSB-ve dhe policisë, e paraqiti, togeri policor Fatmir Limani, nga drejtoria e policisë në bashkësi. “Qëllimi i këtij bashkëpunimi, mes Policisë në Bashkësi dhe Ekipeve Vepruese për Siguri në Bashkësi, është krijimi i një ambienti të sigurt për qytetarët”, tha togeri Limani.

Në kuadër të këtij takimi, ishte, edhe prezantimi i historikut të Komunës së Malishevës dhe resurseve që ka Malisheva, të cilën e bëri, anëtari i EVSB-së në Malishevë, z.Astrit Krasniqi, i cili edhe e ka moderuar tërë takimin e sotëm.

Kurse për aktivitetet dhe rolin e EVSB-së në Malishevë, foli koordinatori në Malishevë, z.Sejdi Paçarizi. Koordinatori Paçarizi, tha se “EVSB në Malishevë, është munduar maksimalisht të gjejë një zgjidhje për qentë endacak, si një prej problemeve kryesore, por KK i Malishevës, nuk ka miratuar tentimin e krijimit të një azili për qentë endacak. Pastaj është angazhuar në vendosjen e kamerave të sigurisë në disa shkolla, pastaj aktivitete të ndryshme të pastrimit të ambientit dhe disa aktivitete tjera”.

Më pas edhe koordinorët e qendrave tjera të EVSB-ve, kanë paraqitur punët dhe aktivitetet e EVSB-ve në qendrat komunale në Kosovë.

Begaj, shtroi iftar për familjet e dëshmorëve

Malishevë, 15 korrik



Në kuadër të muajit të shenjt të ramazanit, kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, mbrëmë ka shtruar iftarin tradicional, për familjet e dëshmorëve të Komunës së Malishevës. Me këtë rast, janë bërë edhe lutje për dëshmorët e kombit dhe nga ana e krerëve të Bashkësisë Islame në Malishevë, janë kënduar edhe pjesë të Kuranit.

“Të lutemi për dëshmorët e kombit.

Duke ju falënderuar atyre djemve, që dhanë jetën për atdhe, ne sot jemi këtu dhe lirshëm darkojmë dhe bëjmë iftar, bëjmë lutje dhe bëjmë organizime tjera, falë gjakut të dëshmorëve”, tha mes tjerash kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj.

Ndërsa, mulla Xhevat Kryeziu, nga Bashkësia Islame në Malishevë, duke folur në këtë iftar, tha se “dëshmorët e kombit, janë të ngritur në shkallën më të lartë të xhenetit. Pa gjakun e tyre, ne nuk do ishim këtu sot. Gjaku i tyre, i ka sjell këto të mira që ne sot i gëzojmë”.

Më pas, hoxhallarët bënë lutje për dëshmorët e kombit dhe kënduan pjesë nga Kurani.

Ndihmohen 180 familje në prag të festës së Bajramit

Malishevë, 15 korrik



Në prag të festës së Bajramit, njerëz të vullnetit të mirë dhe organizata humanitare, sot kanë ndihmuar 180 familje nga Komuna e Malishevës, me pako ushqimore dhe ndihma tjera. Mërgimtari Halim Hoti nga Carralluka e Malishevës dhe organizata HAI, janë ata që sot po ndihmojnë familjet në nevojë, që edhe këto familje, të presin Ditën e Bajramit, me të gjitha të mirat në tryezën e tyre.

Humanisti Halim Hoti, i cili punon dhe jeton në Suedi, nga fshati Carrallukë, ka ndarë pako ushqimore, miell, detergjent dhe gjëra tjera të nevojshme për tridhjetë familje nga Komuna e Malishevës. “Nuk jam i pasur, por jam një qytetar i thjeshtë, si të gjithë të tjerët. Unë jetoj në Suedi, por mendja ime gjithmonë është në vendlindje dhe duke parë gjendje socio-ekonomike të këtyre familjeve, kam shprehur dëshirën ti ndihmoj së paku këto tridhjetë familje, për festën e Bajramit”, tha për Zyrën për Informim të Komunës së Malishevës, z.Hoti. Mërgimtari Hoti, njihet si një humanist i madh, i cili ka ndihmuar në ndërtim të shtëpive për familjet në nevojë, pastaj ka ndihmuar edhe Qendrën e Rehabilitimit-HandiKOS në Malishevë, si dhe në rastet e festave, ndihmon në forma të ndryshme, familjet në nevojë, jo vetëm në Malishevë, por edhe në komunat tjera të vendit.

Po ashtu edhe organizata Human Appeal International (HAI), po ashtu për familjet në nevojë, ka ndarë 150 pako ushqimore.

Të gjitha këto ndihma, janë shpërndarë në bashkëpunim me komunën, përkatësisht me kryetarët e fshatrave, të cilët edhe i kanë identifikuar familjet që nuk kanë të ardhura dhe nuk marrin as ndihma nga skema sociale.

Kryetari Begaj, uron të gjithë besimtarët islam me rastin e Fitër Bajramit

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, me rastin e përfundimit të muajit të shenjt të Ramazanit dhe festës së Fitër Bajramit, i uron të gjithë besimtarët e besimit islam.

“Me përfundimit e muajit të shenjt të Ramazanit, uroj që të gjithë agjëruesve, t’iu pranohet agjërimi. Po ashtu me rastin e festës së Fitër Bajramit, për të gjithë besimtarët e besimit islam në Komunën e Malishevës, ju dërgoj urimet më të sinqerta. Zoti na ndihmoftë në rrugëtimin

tonë të përbashkët”, thuhet në urimin e dërguar nga Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj.

Kryetari Begaj, i uron edhe të gjithë bashkatdhetarët nga Komuna e Malishevës, të cilët jetojnë dhe punojnë në botën e jashtme dhe të cilët, nuk kanë mundur të jenë në shtëpitë e tyre me rastin e Bajramit.

“Urime Festa e Fitër Bajramit”

Krasniqi: Raporti i auditorit tendencioz dhe jo real. Presim marrjen e masave nga organi përkatës

Malishevë, 20 korrik

Sot në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve, i cili drejtohet nga i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj, drejtori për buxhet dhe financa, z.Vesel Krasniqi, e ka sqaruar raportin e auditorit, të cilin e ka quajtur të qëllimshëm dhe tendencioz, pasi personi që e ka bërë auditimin, nuk ka qenë bashkëpunues dhe nuk i ka marrë parasysh faktet dhe komentet, si dhe nuk ka kërkuar sqarime lidhur me “gjetjet” e pretenduara.

“Pas publikimit të raportit të auditorit, ne kemi zhvilluar një takim me auditorin e përgjithshëm dhe në këtë takim, edhe vet auditori i përgjithshëm, është pajtuar se raporti është jo real. Auditori i përgjithshëm, e ka pranuar se nuk janë marrë parasysh komentet tona. Ne i kemi dëshmitë dhe faktet dhe presim nga organi përkatës, që të merr masat e duhura në raport me personin që ka kryer auditimin, si dhe të sqaroj edhe opinion lidhur me këtë raport të publikuar, i cili nuk është real, por që na ka dëmtuar në raport me opinion”, ka thënë drejtori për buxhet dhe financa, z.Vesel Krasniqi, duke e sqaruar Këshillin e Drejtorëve, lidhur me raportin e publikuar nga auditori.

Përndryshe, në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, janë diskutuar edhe çështje të tjera, që kanë të bëjnë me punët e përditshme të qeverisë komunale. Në këtë mbledhje, u tha se po vazhdojnë të realizohen disa projekte, si trotuare, kanalizime, fusha sporti, të cilat kanë filluar javën e kaluar, ndërsa projektet tjera, janë në realizimin e sipër.

Po ashtu në këtë mbledhje u bë e ditur, se me rritjen e temperaturave, është shtuar numri i personave që ankohen se kanë probleme me ujë për pije, e po ashtu edhe në sektorin e shëndetësisë, u bë e ditur, se me rritjen e temperaturave, është shtuar edhe numri i pacientëve në QKMF.

Nga drejtorja për bujqësi, u tha se rendimentet e grurit janë jo të kënaqshme këtë vit, në territorin e Komunës së Malishevës, mirëpo, cilësia e grurit është shumë e mirë. Fushata e korrje shirjeve, po shkon drejt përfundimit.

Sa i përket kulturës, u njoftua se po punohet intensivisht në përgatitjet për festivalin tradicional “Oda e Llapushës”, i cili mbahet në kuadër të ditëve të mërgatës.

Po mbahet Kampi Rinor dy ditor në liqenin e Mirushës

Malishevë, 23 korrik



Organizuar nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, Qendra Rinore dhe OSBE , po mbahet Kampi Rinor dy ditor në liqenin e Mirushës. Pjesëmarrës të këtij kampingu janë rreth 40 të rinj të Malishevës. Këtë kamp e ka vizituar dhe përshëndetur edhe drejtoresha për Kulturë Rini e Sport znj. Blerta Krasniqi.

Qëllimi i organizimit të Kampit Rinor është të krijoj mundësi për vullnetarët ekzistues dhe vullnetarët të mundshëm që të ngrisin kapacitetet dhe rritëzimin përmes aktiviteteve të ndryshme. Gjithashtu të ofrojnë përkrahje komunës në promovimin e vlerave të vullnetarizmit tek rinia. Të gjitha këto planifikohen të arrihen përmes prezantimit të rregullores për vullnetarizëm respektivisht përparmit vullnetarë.

Në kuadër të kampingut janë paraparë këto aktiviteteve si lojëra të ndryshme sportive , prezantimi i rregullores komunale të vullnetarizmit, promovimi i punës së KVRL-së, dhe Qendrës Rinore, dhe aktivitete të lira, ndërsa për ditën e dytë të datës 24, parashihet të mbahen ligjëratë për sigurinë në trafik dhe sigurinë e përgjithshme –Policia e Kosovës, ligjëratë për sëmundjet e transmetueshme –Përfaqësuesit e QKMF-së dhe aktivitete artistike (poezi, skeç këngë etj...)

Kampi është përkrahur financiarisht nga komuna e Malishevës, OSBE dhe Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit.

Mungesa e reshjeve po përcillet me reduktime në furnizim me ujë për pije

Malishevë, 27 korrik

Këshilli i Drejtorëve, i udhëhequr nga kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur sot takimin e rregullt, ku me këtë rast, drejtorët e drejtorive kanë raportuar për punët dhe aktivitetet e drejtorive që ata drejtojnë, për javën që lamë pas dhe për planifikimi për javën në vijim.

Fillimisht drejtori për mbrojtje dhe shpëtim z.Ahmet Morina ka bërë të ditur që javën e kaluar kjo drejtori ka pasur një vllug të punëve, “ Kemi pasur mbi 26 raste në të cilat është intervenuar, nga njësia e Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, ku një ka qenë zjarr në shtëpi banimi

dhe 17 raste tjera kanë qenë zjarre fushore, djegie të mbeturinave, pasuri të tjera dhe në disa stalla, e po ashtu kemi pasur pesë aksidente në komunikacion, ku të vdekur nuk ka pasur fatbardhësisht” u shpreh Morina.

Drejtori për Urbanizëm z.Skënder Rrahmanaj bëri të ditur se aktualisht janë duke u realizuar disa projekte, kryesisht në infrastrukturë, si në infrastrukturë shkollore, rrugore, kanalizime, në fshatra të ndryshëm të komunës së Malishevës. Dhe po ashtu bëri të ditur se projekti i çerdhes së fëmijëve ka përfunduar.

Sa i përket shëndetësisë drejtori z.Hajdin Berissha, tha se “ Është shtuar numri i aksidenteve, dhe kjo reflekton edhe në punën dhe ngarkesën e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare. Po përcillet edhe situata epidemiologjike me EHKK, që tani për tani është e qetë, dhe shpresojmë të vazhdoj kështu”.

Drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport, ka bërë të ditur, që javën e kaluar është mbajtur Kampi Rinor, i cili ka shkuar mirë, po ashtu po bëhen edhe përgatitjet për mbajtjen e festivalit “Oda e Llapushës” , përgatitje të cilat janë në përfundim e sipër.

Krejt në fund drejtori i njësisë së ”Hidroregjioni jugor”, z.Njazi Bytyçi, tha se “ Furnizimi me ujë për pije, në të gjitha fshatrat që menaxhohen nga kjo njësi, është i kënaqshëm dhe kualiteti i ujit është i mirë, por ka reduktime për shkak të mungesës së ujit si pasojë e mungesës së reshjeve të shiut. “Jemi duke punuar edhe ne eliminimin e kyçjeve ilegale të cilat po shkaktojnë telashe të mëdha me furnizim me ujë, dhe qytetaret të cilët po bëjnë keqpërdorime sa i përket ujitjes së arave do të kenë pasoja”, tha Bytyçi.

K.N. “Besa”, fituese e garës së notit - “Esmir Shala”

Malishevë, 28 korrik



Sot në pishinat e Banjës, për herë të parë është mbajtur gara e notit “Esmir Shala”, ku fituese e kësaj gare doli Klubi i Notit “Besa” nga Banja, pasi në garën mes gjashtë klubeve sa ishin pjesëmarrëse, “Besa” zuri vendin e parë për meshkuj dhe vendin e dytë për femra. Në këtë garë, morën pjesë edhe veteranët e notit kosovar. Kjo garë zyrtare e notit, mbahet në nderim të ish reprezentuesit të Kosovës në not dhe anëtarit të KN “Besa”, Esmir Shala dhe u organizua në bashkëpunim mes Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Malishevë, klubit të notit “Besa” dhe Federatës së Notit të Kosovës.

Hapjen e gara e bëri i pari i Malishevës, z.Ragip Begaj. “E ndiej veten të nderuar që kam rastin të hap këtë garë tuajën të sotme, ne emër të njeriut të Banjës, i cili edhe përkujtohet sot, për të cilin kemi respekt të madh, sikur edhe për familjen e tij. Si do që të jetë, këto gara që

po organizohen në emrin e këtij të riu që sot nuk është në mesin tonë, por që besoj se ai do të jetë i gjallë gjithëherë për arsye se gjithë herë do të kujtohet”. Të gjithë të pranishmëve, ju falënderoj për pjesëmarrjen e juaj në këtë garë të notit në fshatin Banjë. U jam mirënjohës edhe organizatorëve dhe klubit “Besa” të Banjës të cilët kanë qenë një ndër klubet e para në Kosovë të notit. Ju uroj shumë sukses të gjithëve në këtë garë, dhe besoj që këta të rinj dhe të reja do të jenë nesër edhe përfaqësues të Kosovës edhe në arenën ndërkombëtare”.tha Begaj, në fjalën e tij të hapjes së garave.

Ndërsa Kryetari i Federatës së notit të Kosovës, z.Imer Rama, fillimisht ka përshëndetur familjen e të ndjerit Shala, dhe i uroi suksese klubit nga Malisheva (KN “Besa) për iniciativën dhe që e kanë mundur që kjo garë të futet në kalendarin e garave të notit, dhe uroi që gara të ketë një tretman të mirë.

Në garat e notit morën pjesë 6 klube, dhe në rezultatet e përgjithshme vendi i parë për meshkuj i takoi, K.N”BESA”, vendi i dytë i takoi K.N”TERMO”, dhe vendi i tretë K.N”ZENIT”, ndërsa tek femrat, vendi i parë i takoi K.N”LLAPI”, i dyti K.N”BESA”, dhe vendi i tret K.N.”ZENIT”. garat u zhvilluan në disiplinat: 50 m Delfin, 100 m krol, 100 m Shpinë, 100 m Bretkosë, 4x50 m Krol (stafeta), 50 m Krol, 200 m Mix, 50 m Shpinë, 50 m Bretkosë, 4x50 m Mix(Stafeta).

Këtë garë e kanë nderuar edhe veteranët e notit të cilët edhe kanë garuar, ku vendi i parë i takoi veteranit Vesel Krasniqi.

Përfundon fushata e korrje-shirjeve në Malishevë

Malishevë, 29 korrik



Fushata e korrje shirjeve në territorin e Komunës së Malishevës, edhe zyrtarisht ka përfunduar sot, ku rendimentet e grurit, kanë qenë jo të pritshme, mirëpo cilësia e grurit ka qenë e mirë. Fushata e korrje shirjeve ka zgjatur 23 ditë dhe në këtë fushatë kanë qenë të angazhuara 45 kombajna, përderisa të mbjella me grurë kanë qenë 3780 hektar.

Drejtori për Bujqësi në Komunën e Malishevës, z.Hajrullah Mazreku, e ka cilësuar të suksesshme fushatën e korrje shirjeve, mirëpo sipas tij rendimentet kanë qenë jo të kënaqshme. “Rendimentet e grurit janë sjellë nga tre mijë deri në tremijë e katërqind kilogram për një hektar, mirëpo kualiteti i grurit ka qenë i mirë”, tha drejtori Mazreku.

Sipas drejtorit Mazreku, gjatë fushatës së korrje shirjeve kanë qenë të përfshira rreth 45 autokombajna, kurse sipërfaqja realizuar e korrjeve është : Grurë 3780 ha, Tërshërë 29 ha, Elb 10.4 ha. E gjithë sipërfaqja e korrur me këto kultura është në sektorin privat.

Kryetari Begaj priti kampionin e botës në kik boks Dardan Morina

Malishevë, 30 korrik

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, së bashku me stafin e tij ka pritur sot në zyrën e tij dymbëdhjetë herë kampionin e botës në kik boks, Dardan Morina, që vjen nga fshati Drenoc i Komunës së Malishevës, që jeton dhe vepron në Ingolstadt të Gjermanisë.



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, pasi që e priti dhe e falënderoi për vizitën me këtë rast i ka dhënë dhe një medalje dhe simbol të komunës së Malishevës.” Unë e ndiej veten sot jashtëzakonisht të kënaqur që pata rastin që në mandatin tim të pres një kampion të shumëfishtë botëror dhe një qytetar të Malishevës, dhe sinqerisht ju dëshiroj shumë suksese dhe të keni të arritura të mëdha në arenën ndërkombëtare. E gjithë Komuna e Malishevës mburret me Dardanin dhe sportist të tillë janë ambasador të vendit tonë në perëndim” tha Begaj duke i dëshiruar suksese të pandalshme.

Ndërsa kik boksieri, Dardan Morina tha se ”ndihet shumë i gëzuar, dhe kjo pritje nga komuna ime me jep vlerë për arritjet e mia deri më tani, dhe për të vazhduar”. Kik boksieri Morina shpreson që në të ardhmen edhe të bëjë marrëveshje, për të ndihmuar sportin malishevas dhe kosovar.

Simbolin e Komunës së Malishevës, të dhënë nga kryetari Begaj, e vlerësoi lartë . “ Kryetari tha se është një gjë e vogël kjo çka më dhuroi, mirëpo për mua është shumë e madhe dhe më gëzon shumë” tha kampioni i botës Morina, duke folur më pas për sfidat e radhës të cilat e presin, ku një ndër motivet për të mbrojtur titullin e radhës tha se është edhe simboli i Malishevës, është fshati i tij Drenoci dhe krenaria që është shqiptar.

U mbajt debati “Të rinjtë kundër duhanit” në Malishevë

Malishevë, 30 korrik

Sot në kuadër të aktiviteteve të shoqërisë civile, u mbajt debati “ Të rinjtë kundër duhanit” i cili është organizua nga OJQ – Grupi Lokal i Veprimit ‘’ Llapusha’’ në Malishevë, me përkrahjen e MKRS-së. Qëllimi i këtij debati ishte ngritja e vetëdijes tek te rinjtë për mos përdorimin e duhanit. Në këtë takim mori pjesë nënkryetari i komunës së Malishevës z. Rexhep Mazreku, Drejtori për Shëndetësi, z. Hajdin Berisha , përfaqësuesi nga Drejtoria e



Inspektoratit, përfaqësuesi nga DKRS, kryetari i Qendrës Rinore, përfaqësuesi i KVRL në Malishevë dhe përfaqësuesit nga shoqëria civile e të tjerë.

Nënkryetari i komunës së Malishevës z.Rexhep Mazreku në fjalën e tij paraqiti angazhimin e institucioneve komunale në zbatimin e ligjshmërisë dhe rregulloreve komunale, të cilat e bëjnë të mundur kontrollimin dhe parandalimin e përhapjes së dukurive negative,

e në këtë rast edhe parandalimin e pirjes së duhanit nga moshat e reja.

Ai përshëndeti zbatimin e këtij projekti dhe vlerësoj që duhet të bashkëpunohet me të gjithë mekanizmat institucional qeveritar e joqeveritar, që të rinjtë tanë të i përkushtohen më shumë aktiviteteve të dobishme, kulturës së mirëfilltë edukative e shëndetësore dhe shprehni gatishmërinë e komunës për të rritur efektivitetin e zbatimit të ligjshmërisë që parandalojnë dhe ndëshkojnë dukuritë negative në shoqërinë tonë.

Koordinatorja e projektit znj. Valbonë Gashi paraqiti aktivitetet dhe synimet e projektet të cilat janë realizuar dhe do të realizohen deri në përfundim të projektit, duke përmendur këtu edhe realizimin e fushatave dhe trajnimeve të cilat kanë qenë dhe janë pjesë e projektit ” Të rinjt kundër duhanit”

Të rinjtë kundër duhanit ishte moto e debatit i cili shqyrtoj në agjendën e vet aspekte e zbatimit të ligjit për kontrollimin e duhanit dhe vetdijësimin e të rinjëve për të parandaluar pirjen e duhanit, që çdo ditë e më shumë po bëhet më shqetësuese sa i përket rritjes së numrit të duhanpirësit edhe tek moshat e reja. Ky projekt është pjesë e agjendës kombëtare kushtuar 31 Majit – Ditës Ndërkombëtare kundër duhanit dhe implementohet nga OJQ- GLV “ LLAPUSHA” në Malishevë.

Malishevë, 65 raste zjarri vetëm në muajin korrik

Malishevë, 30 korrik



Drejtorja për mbrojtje dhe Shpëtim, gjatë këtij muaji , ka qenë bartëse e aktiviteteve në përgatitjen dhe menaxhimin e emergjencave në territorin e komunës së Malishevës, e cila ka menaxhuar dhe koordinuar me sektorët mvarës në kryerjen e punëve dhe detyrave të parashtruara sipas planit të punës për vitin 2015, dhe në përputhshmëri me Ligjin, dhe urdhëresat administrative që janë në fuqi.

Muaji korrik 2015, karakterizohet me temperatura të larta dhe periudha të gjata pa të reshura atmosferike, gjë që ka ndikuar që ekipet profesionale të reagojnë në intervenime të shtuara. “Njësia profesionale për Zjarrfikës

dhe Shpëtim(NjPZSH) , gjatë këtij muaji ka reaguar në më tepër se 65 raste si në shuarjen e zjarrëve, zjarre malore, fushore, shtëpi banimi, shtalla pastaj ushqime bagëtish dhe intervenime tjera teknike” tha drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim z.Ahmet Morina.

DKMSH apelon tek qytetarët e komunës së Malishevës që të mos u ekspozohen rrezeve të diellit dhe ti reduktoj lëvizjet gjatë ditës që nga ora 10:00 deri në ora 17:00, si dhe të marrin masat preventive ndaj zjarrit. Në raste të zjarrit dhe të emergjencave të tjera të lajmëroheni në numër të telefonit 112.

Kryetari Begaj priti palët

Malishevë, 31 korrik

Kryetari Begaj, hapi dyert për qytetarët e Malishevës, si dhe çdo të premte tjetër, ku i dëgjoi hallet dhe problemet me të cilat qytetarët e Malishevës po ballafaqohen, për të ju dhënë ndihmë dhe këshillat e nevojshme në zgjedhjen e këtyre problemeve.

Problemet e shfaqura sot nga qytetarët ishin kryesisht, çështjet socio-ekonomike, çështja për banimi, renovime të shtëpive, infrastrukturë, dhe çështja e punësimit. Kryetari Begaj me këtë rast ju ofroj mbështetjen e institucionit të kryetarit dhe u premtoj atyre ndihmën në ballafaqimet me problemet dhe shqetësimet të cilat i shprehën para tij në takimet e sodit.